



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Në bazë të nenit 17 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 17 parag. 1 dhe 8 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, nr. 04/L-174 dhe nenit 19 shkronja b të Statutit të Komunës së Podujevës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 mars 2015, miratoi,

VENDIM

PËR INICIMIN E PROCEDURËS PËR REVIDIMIN E PLANIT DETAJ URBANISTIK TË KOMPLEKSIT PODUJEVA II

Neni 1

Inicohet procedura për revidimin e Planit Detaj Urbanistik të kompleksit Podujeva II, i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës, nr. 01-1/87-02 të datës 10.05.2007.

Neni 2

Hartimi i propozimit të revidimit të Planit Detaj Urbanistik të bëhet konform dispozitave ligjore dhe dispozitave nënligjore për shfrytëzim racional të hapësirës përkatëse në funksion të krijimit të kushteve për plotësimin e nevojave zhvillimore dhe caktimin e kriterëve ndërtimore.

Neni 3

Hartimi i propozimit të revidimit të Planit Detaj Urbanistik të bëhet në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, nr. 04/L-42.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bënë Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Neni 5

Vendimi hynë në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-350-36516
Podujevë,
31 mars 2015



Kryesuesi i Kuvendit
Mehtmet Gashi